




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 117/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Uni Care Shpk”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik” me nr. prok. 70010/17/172/121, iniciuar nga AK-/Spitali Regjional Prizren/ më datën 12 qershor 2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Uni Care Shpk”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik” me nr. prok. 70010/17/172/121, iniciuar nga AK-/Spitali Regjional Prizren/.
- II. Anulohet**, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së /Spitali Regjional Prizren/, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik” me nr. prok. 70010/17/172/121 dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
- III.** Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar

dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Uni Care Shpk"- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:14.02.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt:17.03.2017 ku kanë marr pjesë pesë operator ekonomik.

Letra standarde për tenderues të eliminuar është dërguar me dt:04.04.2017

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:19.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Biotek Kosova LLC"- Mitrovicë.

Kundër njoftimit për tenderues të eliminuar, operatori ekonomik Uni Care Shpk" – Prishtinë, me dt: 07.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 11.04.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet si pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Uni Care Shpk"-Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues "Uni Care Shpk"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.04.2017 me nr. 117/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
- Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi,
- Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve,
- Neni 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 02.05.2017 ka autorizuar ekspertët e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 12.05.2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që ta Aprovoj si të bazuar ankesën OE "Uni Care Shpk"-Prishtinë" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të anuloj vendimin "Njoftimin për dhënie të kontratës, i datës 19.04.2017, me titull: "Furnizim me aparat analizier biokimik-automatik" me nr. prok. 70010/17/172/121 iniciuar nga AK- Spitali Regjional Prizren, dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-Vlerësim

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 16.05.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 16.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.06.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertët e OSHP-së, vëzhgues nga OJQ "D Plus" znj. Sara Zhubi dhe z. Isuf Zejna, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Uni Care Shpk"-Prishtinë Arsyeya pse kemi bërë ankese në OSHP është se kur kemi marr ekspertizën e ekspertit nuk jemi pajtua me vlerësimin që është bërë në pikën ku kërkohet autorizimi për shitje dhe servisim. Duhet të shtoj që në dosje të tenderit kemi ofruar dëshmi për autorizimin në tender për shitje dhe servisim të pajisjes në fjalë.

Në tender ka qenë një autorizim nga prodhuesi ABOT nga Amerika, që ne kemi bashkëpunim me shumë se 10 vite dhe jemi përfaqësues-distributor ligjor të vetëm në Republikën e Kosovës. Kur kemi dorëzuar autorizimin nga AK na janë kërkuar disa informata shtesë. Me datë 29.03.2017 na është kërkuar kërkesë për sqarim në pikat që ka cek AK-ja. Duhet cekur se ka kërkuar përgjigje brenda dy ditëve. Sipas rregullores dhe UOPP afati duhet të jetë deri në 5 ditë. Ne me atë kohë të shkurtë dhe me një prodhues si ABOT ka qenë e pamundur që të garantojmë një deklaratë-autorizim të tillë nga prodhuesi, por i njëjti autorizim na është dërguar nga qendra në Zagreb, që është qendër për distribuim në Ballkan. Ne kemi arritur të marrim një autorizim të Eënd dhe brenda dy ditëve i kemi ofruar AK-së. Në autorizimin e kësaj dite, prodhuesi garanton për autorizim me marr pjesë në tender, me negociu kontratën ku përfshihet start Up, trajnimi si dhe servisimi e mirëmbajtja.

Është e cekur po ashtu se do garantojnë mbështetje për 5 vite sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Për këtë arsye çdo fillim vit me prodhuesin ABOT na lëshojnë një autorizim të tillë, çka dëshmon se jemi distributor në Kosovë. Për pikat tjera 3 dhe 4 të ekspertizës pajtohemi me konstatimin e ekspertit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Ahmetaj deklaroj: Ne si AK qëndrojmë pranë vendimit të datës 11.04.2017, pas kërkesës për rishqyrtim lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, në cilën prej AK-së është kërkuar autorizimi për shitje dhe servisim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar.

Kërkesa ka qenë të kapaciteti teknik dhe profesional për shitje dhe servisim, ndërsa Uni Care ka ofruar autorizim nga prodhuesi në të cilën ceket për pjesëmarrje, negociata dhe nënshkrim të kontratës. Pas kërkesës për sqarim nga OE, me datë 31.03.2017 na ka ofruar letrën për informim, jo autorizim prej prodhuesit. Hapja e ofertave është bërë me 27.03.2017. Katër dite pas hapjes OE ka ofrua letrën e informimit, me të cilën sipas LPP neni 72.3 thuhet "dokumentacioni dhe informacioni shtesë, sigurimi i informacionit që mungon do të aplikohet vetëm për dokumente ekzistenca e të cilave është fiksuar para skadimit të afatit të tenderëve e cila mund të verifikohet në mënyrë objektive". Ky dokument prej OE ankues është ofruar katër dite me vonese dhe kjo nuk lejohet me LPP. Ne kemi hy në vlerësim me OE që ka qenë në eliminimin në fazë fillestare. Ndoshta ka qenë gabim i yni që kemi vazhduar me ofertën e OE ankues pasi është dashtë ta eliminojmë që në fillim.

Sa i përket fotometrit, ka një domen shumë të gjerë nga 200 nm deri i 2500 nm. Kërkesa jone ka qenë prej 340nm deri në 800nm. Mirëpo aparati në fjalë punon në principin e spektrofotometrisë dhe ka 16 lloje të matjeve. Pjesa teknike nuk ka bërë diferencimin e spektrofotometrit me fotometrin. Aparati në fjalë ka 16 parametra të kufizuar. Ne asnjëherë pike për specifiika teknike OE ankues nuk plotëson kërkesat e AK-se. Pika katër kyçe, aparati në fjalë punon në sistemin e mbyllur, që i bie se ky aparat përdor reagensat ekskluzivisht vetëm

të këtij prodhuesi. Ne nuk është dashtë të bëjmë tender publik të blejmë aparat kur aparati i tillë neve na ofrohet me zero euro. Edhe po ta na ofrohej me zero euro nuk do e mernim pasi çmimi i reagjentëve të prodhuesit janë jashtëzakonisht të shtrenjta dhe spitali Përgjithshëm në Prizren nuk është në gjendje me i përballu këto shpenzime. Ne kemi dashtë të blejmë aparat mirëpo te mos jemi te varur për reagenca nga i njëjti prodhuesi, por te implementohen lloje te ndryshme të reagjentëve. Përndryshe nuk do jemi korrekt ndaj OE-ve tjerë.

Kivetat e kuarcit janë kërkesë pasi janë shume më të qëndrueshme dhe për periudhë te gjate nuk kanë nevojë të ndërrohen.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues teknik z.Hoti deklaroi: Sa i përket pikës së parë, sqarimit që AK vet e sqaroj se u be kërkesa, OE e ka gjatësinë valore 340 deri 840nm, do të thotë përfshinë kërkesat e shtruara nga vet AK, në të cilat janë përshkruar 16 gjatësi valore duke filluar prej 340nm që përfshinë edhe kërkesën 350nm.

Gjatësia valore e aparatit Architect C8000. Po ky aparat sa i përket parimit të fotometrisë sqaroj se fotometria është pjese e spektrofotometrisë e cila e mbulon në qoftë se ka nevojë edhe potenciometrin, nefelometrinë dhe ate në gjatësi valore prej 340nm deri në 804nm.

Metoda e matjes se fotometrise është një teknikë që mund të përdoret për të matur përqendrimeve e komponimeve organike dhe inorganike me zgjidhje duke përcaktuar absorbimin e gjatësisë se valëve specifike të dritës. Aparati Architect C8000 është me i avancuar se kërkesa e AK-se. Sa i përket pikës 4, rreth memorizimit te aparatit është kërkuar nga AK memorizim 100.000 mostra. Pas hulumtimit të aparatit të ofruar nga OE është gjetur të dhëna që ofrojnë një memorizim duke tejkaluar 100.000 mostra, në bazë të memorizimit 2 TB.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE "Uni Care" deklaroi: Ne i jemi përgjigjur AK-së në kërkesë ende pa kaluar 48 ore. Informatat që thotë për autorizimin, me qene se janë pajtuar me gjitha pikat ne jemi thirrur vetëm për piken e autorizimit. Informacionet shtesë kanë qene si information letter ngase ne kemi dorëzuar një herë autorizimin, dhe kjo letër informimi vetëm se e sqaron atë autorizim. Duhet te shtoj se sistemi në fjalë është sistem i mbyllur. Mirëpo sistemi i ofruar nga OE-te tjerë nuk qëndron se është i hapur, aspi edhe ta kane sistem te mbyllur. OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka ofruar sistem te mbyllur. Gjithashtu reagensat nuk qëndron se çmimi është me i lartë se pajisja. Gjitha pikat i kemi personat përgjegjës te ABOT.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e Ak së sipas kërkesës tuaj qe OE të ketë autorizim nga prodhuesi ose dileri autorizuar,, a ka ofruar OE ankues autorizim para hapjes se ofertave.

Në përgjigje z.Ahmetaj deklaroi: OE para hapjes ka dorëzuar një autorizim vetëm për pjesëmarrje, dhe nënshkrim të kontratës, në të cilin nuk ceket sipas kërkesës të AK për shitje dhe servisim. Në sqarimin e dhënë nuk thuhet se është për shitje.

Anëtari i panelit shqyrtues z.Dina pyeti ekspertin teknik se a plotëson kërkesat e AK produkti i ofruara prej OE ankues? Në përgjigje z.Hoti deklaroi:Po i plotëson kërkesat e AK-së.

Në fjalën përfundimtare z.Bajraktari deklaroi:I propozojmë panelit shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se autoriteti kontraktues pa të drejtë e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se nuk e ka ofruar autorizimin siç është kërkuar në FDT për shitje dhe servisim, pasi që ky operator ekonomik e ka ofruar autorizimin me dosje të tenderit me rastin e ofertimit në të cilin autorizim shkruan që autorizohet për pjesëmarrje në tender, nënshkrim të kontratës. Faktin se autorizimin në fjalë, OE ankues e ka dorëzuar me rastin e ofertimit e ka pranuar edhe vetë përfaqësuesi i autoritetit kontraktues në seancën e mbajtur me dt:12.06.2017 në OSHP. Ndërsa në lidhje me kërkesën e AK-së për sqarime shtesë në lidhje me autorizimin dhe çështjes se a është dërguar ky sqarim brenda afatit apo jashtë afatit të kërkuar nga autoriteti kontraktues, paneli shqyrtues konstaton se edhe sqarimi shtesë ka qenë vetëm si letër informim për autorizimin i cili ka qenë i bashkangjitur në dosje të tenderit të OE ankues me rastin e ofertimit.

Lidhur me pretendimet e OE ankues se është eliminuar pa të drejtë përkitazi me parimin e spektrofotometrisë, memorizimit të aparaturës Abbott C800 dhe rreth qëndrimit të materialit qelq kuarc plastik, ashtu siç kanë theksuar edhe ekspertët e OSHP-së në raportin e tyre të dt:12.05.2017 me nr.117/17 edhe paneli shqyrtues vjen në përfundim se këto pretendime të lartcekura janë të qëndrueshme dhe se operatori konik është eliminuar pa të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues në lidhje me plotësimin e kërkesave të autoritetit kontraktues produkti i ofruar nga ana e OE ankues, ka konstatuar se ky OE i plotëson këto kërkesa, pasi që këtë fakt e ka cekur dhe pranuar edhe vetë eksperti teknik në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:12.06.2017 në OSHP, ku pyetjes së njërit nga anëtarëve të panelit shqyrtues se a i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktues produkti i ofruar, eksperti teknik i është përgjigjur me Po i plotëson kërkesat e AK-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Njëkohësisht është respektuar edhe nenin 60 i LPP-së, respektivisht kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Poashtu paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, pasi që operatori ekonomik ankues nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese, e po ashtu nuk është marr parasysh edhe ekonomiciteti dhe efikasiteti që parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Spitali Regjional Prizren”

1x1 OE “Unicare Shpk”-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.